



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional Waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada  
**KRM "PASTËRTIA" SH.A. - FERIZAJ**  
Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/327-406, 0290/325-025



# **PLANI I BIZNESIT 2023/2025**

Ferizaj, Tetor 2022

<b>1. Përmbledhja ekzekutive.....</b>	<b>3</b>
<b>2. Përshkrimi i përgjithshem/Historia e biznesit.....</b>	<b>4</b>
2.1.Lokacioni dhe asetet ekzistuese.....	4
2.2.Vizioni.....	6
2.3.Misioni.....	6
2.4.SWOT Analiza.....	7
<b>3. Produktet dhe shërbimet.....</b>	<b>7</b>
<b>4. Plani i Marketingut.....</b>	<b>8</b>
4.1.Analiza e tregut.....	9
4.2.Strategjia e Marketingut.....	11
4.3.Plani i Shitjes.....	12
<b>5. Analiza e konkurrentëve në tregun e synuar.....</b>	<b>13</b>
<b>6. Organizimi i biznesit.....</b>	<b>13</b>
6.1.Personeli.....	14
<b>7. Plani Financiar.....</b>	<b>15</b>
<b>8. Sfidat.....</b>	<b>22</b>

## 1. Përmbledhja ekzekutive

Procesi i korporatizimit të Kompanive Rajonale të mbeturinave në Republikën e Kosovës ka filluar në vitin 2007, ndërsa më 1 janar 2008 Kompania Rajonale për mbeturina “Pastertia” në Ferizaj ka filluar të funksionoj si Shoqëri Aksionare në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/4 mbi Ndërmarrjet Afariste për periudhë të pacaktuar kohore. KRM “Pastertia” si shoqëri aksionare është e organizuar sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03-L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123 dhe Ligjit Nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02-L-123 për Shoqëritë Tregtare (2011/04-2006).

Detyrë thelbësore e Kompanisë Rajonale për Mbeturina “Pastertia” Sh. A. është që të ofroj shërbime për grumbullimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në rajonin e vet të shërbimit. KRM “Pastertia” Sh.A. ofron shërbime nën menaxhimin e Bordit të Drejtorëve. Në këtë organ janë të përfaqësuara komunat: Ferizaj, Shtime dhe Kaçanik.

“Pastertia” ka vazhduar të optimizoj shpenzimet dhe strukturën operative dhe të zgjeroj shërbimet për grumbullimin e mbeturinave. Mbulimi i shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave do të rritet në një shkallë të konsiderueshme. Në të kaluarën një numër i konsiderueshëm i popullatës së shërbyer nuk i kanë paguar faturat. Tarifat e caktuara dhe fondet kanë qenë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet totale të operimeve (duke përfshi investimet kapitale) dhe kanë kërcënuar qëndrueshmërinë e ndërmarrjes.

Ky Plan i Biznesit përshkruan rrugën përpara për të arritur një shërbim të grumbullimit të mbeturinave të vetë-qëndrueshëm, efektiv dhe efikas sipas standardeve Evropiane. Aktualisht sistemi i grumbullimit të mbeturinave është derë më derë dhe me kontejner 80/120litra, që është më i afërt me nevojat e qytetarëve. Po ashtu në ndërmarrje ka filluar analiza e mundësisë për ndarjen e mbeturinave.

KRM “Pastertia” Sh.A. do të jetë e përkushtuar në aktivitetet primare në grumbullimin e mbeturinave dhe planifikohet që gjatë vitit që vjen së bashku me komunat të filloj me implementimin e ligjit për mbeturina, në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet dhe të rriten të hyrat. Kjo do të garantoj një zhvillim të vetë-qëndrueshëm të grumbullimit të mbeturinave në rajonin e shërbimit. Duke u bazuar në ligjet që e rregullojnë qështjen e mbeturinave komunale, ndërmarrjet e mbeturinave janë të limituara të shtyjnë klientët të paguajnë për shërbimet për grumbullimin e mbeturinave. Ashtu që KRM “Pastertia” Sh.A. me përkrahjen e vazhdueshme të aksionarëve duhet të mbulojë zbratësinë financiare deri në vitin 2008.

## 2. Përshkrimi i përgjithshëm/Historia e biznesit

Kompania Regjionale për Mbeturina “Pastertia” Sh. A. ka selinë në Ferizaj, Rruga “Enver Topalli” nr. 47 dhe ka tri njësi operative:

- Ferizaj
- Shtime dhe
- Kaçanik.

KRM “Pastertia” Sh. A. që prej themelimit në vitin 1960-të ka ofruar shërbime në menaxhimin e mbeturinave. Që nga viti 2003, njësitë e Ferizajt, Shtimes, dhe Kaçanikut janë konsoliduar Brenda NPRM “Pastertia” dhe ndajnë mes vete asetet punuese. Prej vitit 2008 kompania kalon në organizim si Shoqëri Aksionare dhe në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve Regjistrohet me emrin KRM “Pastertia” SH.A. Kjo punë është kryer me vendim të posaqëm të Qeverisë së Kosovës, Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të amendamentuar me Rregullorën nr 2005/18. Rajoni i shërbimit të KRM “Pastertia” SH.A. përbëhet nga tri qytete (Ferizaj, Kaçanik, dhe Shtime) dhe 102 fshatra (44 ne Ferizaj, 22 ne Shtime, dhe 30 në Kaçanik). Rreth 170.000 banorë jetojnë në këtë rajon (108.610 në Ferizaj, 33.409 në Kaçanik, dhe 27.324 në Shtime). Rreth 81.300 banorë jetojnë në qytete (48%) kurse 88,058 (52%) jetojnë në vendet rurale.

### 2.1. Lokacioni dhe asetet ekzistuese

Kompania Regjionale për Mbeturina “Pastertia” Sh. A. ka selinë në Ferizaj, Rruga “Enver Topalli” nr. 47 dhe ka tri njësi operative:

- Ferizaj
- Shtime dhe
- Kaçanik

Automjete funksionale në shërbim të klienteve:

Mjetet në shërbim	Ferizaj	Shtime	Kaçanik
Kamiona	17	5	5
Kamioneta	1	-	-
Traktora	-	3	1
Autofshisa	-	-	-
Autocisterna	-	-	-
Ngarkues	-	-	-
Vetura(pikap, VË, xhip, merc.)	1	-	-
<b>Gjithesej:</b>	<b>19</b>	<b>8</b>	<b>6</b>

## LISTA E AUTOMJETEVE 2022

1	Mercedes	2022	05-693-GG	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
2	Mercedes	2022	05-694-GG	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
3	Mercedes	2022	05-695-GG	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
4	Mercedes	2022	05-696-GG	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
5	ISUZI	2021	05-202-GJ	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
6	ISUZI	2021	05-203-GJ	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
7	ISUZI	2021	05-204-GJ	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
8	ISUZI	2021	05-206-GJ	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
9	Iveco	1980	05-472-FT	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
10	Iveco	2011	05-971-FK	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
11	Iveco	2011	05-972-FK	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
12	Iveco Calabrese	2001	05-249-AB	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
13	Kamioneta FORD	2003	05-611-EH	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
14	Mitsubish	2009	05-348-BH	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
15	Mitsubish	2009	05-428-BH	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
16	Mitsubish	2011	05-623-BL	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
17	MAN M05	1990	05-267-CM	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
18	Mercedes-Benz 22 25 6x2	1983	05-978-EB	Bartje e mbeturinave	Ferizaj
19	Merc.Benz B180 CDI	2005	05-625-CP	Veture	Ferizaj
20	Mercedes	2022	05-692-GG	Bartje e mbeturinave	Shtime
21	ISUZI	2021	05-208-GJ	Bartje e mbeturinave	Shtime
22	ISUZI	2021	05-209-GJ	Bartje e mbeturinave	Shtime
23	Mercedes	1991	05-973-CK	Bartje e mbeturinave	Shtime
24	MAN	2006	05-362-DA	Bartje e mbeturinave	Shtime
25	Ferguson 539	1990		Bartje e mbeturinave	Shtime
26	Ferguson 539	1990		Bartje e mbeturinave	Shtime
27	Ferguson 539	1990		Bartje e mbeturinave	Shtime
28	Mercedes	2022	05-691-GG	Bartje e mbeturinave	Kaçanik
29	ISUZI	2021	05-206-GJ	Bartje e mbeturinave	Kaçanik
30	ISUZI	2021	05-207-GJ	Bartje e mbeturinave	Kaçanik
31	Skania	2006	05-350-NK	Bartje e mbeturinave	Kaçanik
32	Volvo	2003	05-821-EP	Bartje e mbeturinave	Kaçanik
33	Ferguson 539	1990		Bartje e mbeturinave	Kaçanik

## 2.2. Vizioni

Vizioni i ynë është ngritja e nivelit të ofrimit të shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave në qytet dhe në zonat rurale, zgjerimin e shërbimeve në zonat e pambuluara me shërbim, për të siguruar ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët në Regjionin e Ferizajt duke siguruar qëndrueshmëri financiare për KRM “Pastertia”.

## 2.3. Misioni

Misioni i kompanisë është që të mbulojë me shërbime cilësore tërë zonën e shërbimit, të gjithë qytetarët e saj, pa dallim vendbanimin e tyre dhe që të siguroj shërbime në pajtim me standardet ndërkombëtare. Kompania Rajonale për Mbeturina “Pastertia” Sh. A. në Ferizaj si aktivitetet primare ka;

- Mbledhjen e mbeturinave, në komunat e Ferizaj-t, Shtime-s, dhe Kaçanik-ut



Aktivitetet sekondare të KRM “Pastertia” sh.a. tani për tani janë:

- Pastrimi i rrugëve dhe heqja e borës;
- Shërbime tjera si mirëmbajtja se rrugëve

Në kuadër të veprimtarisë primare e kemi mision që së bashku me komuna të bëhet klasifikimi i mbeturinave nga qytetarët dhe ndarja në burim.

## 2.4. SWOT Analiza

<i>Përparësitë</i>	<i>Mundësitë</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimevet për konsumatorë</li> <li>• Partnerët strategjikë (Komunat, Qeveria, Donatorët etj.) të tjera</li> <li>• Përvojë e gjatë në këtë biznes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjerimi i shërbimeve tona duke u zgjeruar në kryerjen e shërbimeve për klientët tanë;</li> <li>• Zgjerimi në ofrimin e llojeve tjera shërbimeve</li> <li>• Krijimi i aleancave me operatorët tjerë për të depërtuar në shërbime tjera</li> </ul>
<i>Dobësitë</i>	<i>Kërcënimet</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e disa mjeteve (Makinerve) relevante të cilat do të plotësonin ofrimin e shërbimeve;</li> <li>• Marketingu jo i zhvilluar në nivel me kërkesat e tregut</li> <li>• Mungesa e furnizimit me kontenjerë të nevojshëm;</li> <li>• Mungesa e trajnimeve të mjaftueshme të stafit për të qenë në hap me nevojat e tregut;</li> <li>• Përshtatja me vështirësi ndaj ndryshimeve të rutinave punuese apo teknologjike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pamundësia e kontrollit të ofrimit të shërbimit vetëm nga ana jonë për shkak të përfshirjes së më shumë operatorëve në ofrimin e këtij shërbimi;</li> <li>• Gjendja jo e mirë e mjeteve transportit dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;</li> <li>• Mungesa e zbatimit të bazës ligjore që rregullon politikën e Shërbimit në komuna nga vete pronaret e aksioneve, gjegjësisht moszbatimi i saj;</li> <li>• Fleksibiliteti i konkurrentëve tanë në aspektin e Shpejtësisë së shërbimit,, çmimit, etj;</li> <li>• Kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse, shportat per amviserit,kontenjerat 1.1,dhe 5 m3</li> </ul>

## 3. Produktete dhe Shërbimet

Kompania Rajonale për Mbeturina “Pastertia” Sh. A. në Ferizaj është përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave (si aktivitet primar) në komunat e Ferizajt, Shtimes, dhe Kaçanikut. Meqenëse ne fshatin Gërlicë gjendet Stacioni i Tansferit të mbeturinave e që është në afërsi të selisë së ndërmarrjes “Pastertia” sh.a. paraqet përparësi të cilën duhet shfrytëzuar.

Në vazhdimësi kemi probleme të mëdha me kompaninë e autorizuar për menagjimin e deponisë. Shpresojmë që në vitet në vijim të konsolidohet kjo kompani, dhe ne mos të detyrohemi t’i transportojm mbeturinat në deponin e Gjilanit dhe asaj të Prishtinës.

Aktivitetet sekondare të KRM “Pastertisë“ sh.a. tani për tani janë:

- Pastrimi i rrugëve dhe heqja e borës;
- Shërbime tjera si mirëmbajtja e rrugëve

Aktivitetet sekondare të Pastërtisë bazohen në kontrata për shërbim me komunat (Ferizaj, Shtime, dhe Kaçanik). Shumica e kontratave për shërbim janë përmes tenderëve publik dhe të hyrat e inkasuara janë substanciale për kompaninë.

Rëndësia e aktiviteteve primare dhe sekondare është të kemi një ambient të pastër për qytetarët, që ndikon në shëndetin e tyre dhe ndalon përhapjen e epidemive të ndryshme.

Kostoja e lartë e ndarjes së mbeturinave nuk mundëson nxjerrjen e ndonjë fitimi nga procesi i riciklimit të mbeturinave. Kompania është e gatshme të bashkëpunojë me investitorët potencial për ndarjen e mbeturinave dhe riciklim.

#### 4. Plani i Marketingut

Në mënyrë që të arrijmë objektivat e lartcekura për vitin 2023-2025 ne kemi kombinuar disa strategji në mënyrë që rezultati të jetë më i mirë dhe më lehtë i matshëm. Në mënyrë që të arrijmë rritjet e parapara ekonomike qoftë në shërbimet e mbledhjes e mbeturinave, pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e hapsirave gjelbruese, ne kemi zgjedhur strategjitë e marketingut adekuate për llojin e shërbimeve dhe nevojat e ndryshme që kanë këto shërbime.

Në shërbimet tona ne do t'i përdorim tri metoda strategjike dhe atë:

- Metoda zgjeruese, ku do të orientohemi drejt klientëve të rregullt;
- Metoda depërtuese/zgjeruese, në drejtim të klientëve potencialë si dhe
- Metoda të avancuar, në drejtim të klientëve të ri.

Në shërbimin e mbeturinave ne do t'i përdorim metodën zgjeruese ku do të orientohemi drejt klientëve të rregullt, metodën depërtuese në drejtim të klientëve potencialë. Në shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapsirave gjelbruese ne do ta përdorim metodën depërtuese e cila do të orientohet në zbrastësit e identifikuar që kemi në treg.

Ndërsa sa i përket realizimit të objektivave tjera që janë cekur më lart qasja jonë do jetë e fokusuar në:

- Kontrollin e kualitetit të punëve karshi rregulloreve dhe standardeve adekuate;
- Aplikimin e teknologjisë (Mjeteve të reja) në proceset e punës;
- Aplikimin e sistemit të shpërblimit dhe ndëshkimit karshi performancës së treguar;
- Shkollimin dhe trajnimet e stafit karshi zhvillimit të fushave përkatëse dhe
- Punësime të reja.

Ndërsa në mënyrë që të përmirësojmë dhe zhvillojmë imazhin e kompanisë sonë, ne kemi planifikuar që të mbajmë një rol aktiv në sponsorimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel vendi.



#### 4.1. Analiza e tregut

Madhësia aktuale e tregut,në vitin 2022 në zonën e shërbimit të Pastërtisë (vlerësim i yni ) është rreth 181,933 banorë, përfshirë edhe banorët e zonës që punojnë jashtë Republikës së Kosovës. Në këtë zonë kanë ekzistuar rreth 33,137 amvisëri (mesatarisht 5.5 banorë në një amvisëri).

Në vitin 2022 deri me 30.09.2022, klientët aktivë të regjistruar në databazën e KRM “ Pastërtia” sh.a. kanë përfshirë:

- 21,494 klient të amvisërisë;
- 2,208 klient të bizneseve të rregullta;
- 470 klient në biznese me kontratë;
- 133 klient të institucioneve;

Në Ferizaj,

Viti	Të dhenat nga ASK REGJISTRIMI 2011	Amvisëritë	Amvisëritë	% e amvisërive	Klientët e regjistruar të bizneseve dhe industr.
	Nr.Banoreve	ekzistuese	e sherbyera- planifikimi	Të sherbyera	
2022	118,574	20,125	18,000	89%	2500
2023	119,522	21,150	19,000	90%	3000
2024	120,464	22,500	22,500	100%	3500
2025	121,428	24,000	24,000	100%	4000

Në Shtime,

Viti	Të dhenat nga ASK REGJISTRIMI 2011	Amvisëritë	Amvisëritë	% e amvisërive	Klientët e regjistruar të bizneseve dhe industr.
	Nr.Banoreve	ekzistuese	e sherbyera- planifikimi	Të sherbyera	
2022	29,827	5,047	3,500	69%	350
2023	30,066	5,088	4,000	79%	400
2024	30,306	5,129	5,129	100%	450
2025	30,550	5,170	5,170	100%	500

Në Kaçanik,

Viti	Të dhenat nga ASK REGJISTRIMI 2011	Amvisëritë	Amvisëritë	% e amvisërive	Klientët e regjistruar të bizneseve dhe industr.
	Nr.Banoreve	ekzistuese	e sherbyera- planifikimi	Të sherbyera	
2022	36,169	6,028	3,269	54%	350

2023	36,458	6,182	3,423	55%	400
2024	36,750	6,232	3,473	56%	450
2025	37,044	6,282	3,573	57%	500

Sipas të dhënave nga Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave, raportohet se konsumi i familjeve në Kosovë në pesë vitet e fundit është rritë 10%. Nga kjo e dhënë supozohet që për 5 vitet e ardhshme sasia e mbeturinave në Kosovë, respektivisht në komunën e Ferizajt do të rritet për 10%, apo përafërsisht 2% për vit. Në qoftëse kësaj rritje i shtojmë edhe rritjen e popullësisë për 0.8% në vitë, rritjen e konsumit për 2% dhe mbulimin me 100% të shërbimeve atëhere sasia e mbeturinave do të rritet për 203%. Nga tabela më poshtë vërejmë që parashikimet për rritje të sasisë së mbeturinave për vitin 2022 do të jenë 312kg/, ndërsa në vitin 2023 sasia do të arrijë kuotën prej 318kg/vit .

Ferizaj:

	2022	2023	2024	2025
Nr i popullsisë me rritje 0.8%	118,574	119,522	120,464	121,428
Sasia e mbeturinave per koke kg/banori/vite	312	318	324	330

Kacanik:

	2022	2023	2024	2025
Nr i popullsisë me rritje 0.8%	36,169	36,458	36,750	37,044
Sasia e mbeturinave per koke kg/banori/vite	154	157	160	163

Shtime:

	2022	2023	2024	2025
Nr i popullsisë me rritje 0.8%	29,827	30,066	30,306	30,550
Sasia e mbeturinave per koke kg/banori/vite	299	305	311	317

## 4.2. *Strategjia e Marketingut*

Duke pasur parasysh shkallën jo të kënaqshme të inkasimit të obligimeve për amvisëritë, vetëdijesimi i publikut duket të jetë në nivel shumë më të lartë. Ne kemi shfrytëzuar dhe vazhdojmë të shfrytëzojmë mjete të ndryshme komunikimi (TV, billboard, fletushka madje planifikojmë të angazhojmë siq kemi bërë edhe në kaluerën edhe një OJQ lokale ) për senzibilizimin e këtij problemi dhe përmirësuar vetëdijesimin e klientëve tonë, po ashtu edhe kemi qenë prezent në reklamat televizive. Gjatë vitit të kaluar, ne kemi qenë prezent edhe në televizionet lokale disa herë , madje edhe të kritikuar, ne ju kemi shpjeguar punën dhe vështirësitë në aktivitetet tona ku po ashtu kemi dhe do të kërkojmë nga klientët tonë ti kryejnë obligimet e tyre.

KRM “Pastertia” Sh. A. ka të punësuar një menaxher për Marrëdhënie me Publikun/ Klientët, për të përmirësuar relacionin me klientët. Këtë vitë do të kemi aktivitete të ndërlidhura më tepër me promovimin e aktiviteteve që nënvizojnë rëndësinë e mbledhjes së diferencuar (të ndarë) të mbeturinave. Këtë aktivitet do ta shtrijmë edhe në shkollat fillore. KRM “Pastertia” Sh. A. në vazhdimësi është pranë klientëve të saj, ajo vazhdimisht i njofton edhe për kohën se kur do të kryhen shërbimet gjatë festave në mënyrë që qytetarët të mos i vendosin mbeturinat në rrugë dhe ato të mbesin për një kohë pak më të gjatë në kontenierët tanë. Ne po ashtu kemi eliminuar në shumë raste deponi ilegale të mbeturinave të krijuara nga individ të papërgjegjshëm. Duhet theksuar se kjo ka pasur një jehonë të mirë. Por kompania ka shpenzuar mjete shtesë për eliminimin e këtyre deponive.

Ankesat vjetore të klientëve vazhdojnë të jenë të vogla. Ato që i paraqesin klientët kanë të bëjnë më tepër me borxhet e të kaluarës, të cilat janë krijuar si pasojë e mosfunksionimit të mirë të sistemit të menaxhimit të mbeturinave si në bartjen e tyre po ashtu edhe në mos kontaktimin e tyre nga ana e inkasantëve si dhe problemeve të tjera të jashtme, në veqanti problemi i vendosjes së kontenierëve. Këtë vitë planifikojmë të bëjmë një studim mbi kënaqshmërinë e klientëve tanë karshi shërbimeve. Për këtë planifikojmë angazhimin e ndonjë Organizate joqeveritare, apo instituti të specializuar të kësaj fushe.

Disa nga pyetjet që do të i parashtojmë e që do të shprehën në përqindje do të jenë;

- ❖ Sa klientë shprehur në përqindje janë plotësisht të kënaqur me përpikshmërinë dhe kualitetin e shërbimit të ofruar.
- ❖ Sa klientë shprehur në përqindje janë plotësisht të kënaqur me kohën e mbledhjes së mbeturinave;
- ❖ Sa klientë shprehur në përqindje janë plotësisht të kënaqur me punëtorët e ndërmarrjes;
- ❖ Sa klientë shprehur në përqindje janë të kënaqur me informimin e publikut;
- ❖ Sa klientë shprehur në përqindje janë plotësisht të kënaqur me performimin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja ka marrëdhënie të mira dhe bashkëpunon mirë me të gjitha komunat në zonën e shërbimit, por komunat zakonisht vonohen në pagimin e faturave të tyre. Por tani edhe me ligj komunave u janë dhënë përgjegjësitë në menaxhimin e mbeturinave, kështu tani nuk mund të ankohen në kompetencat e komunave. Ndërmarrja bashkëpunon mirë me inspektorët komunal të cilët përpiqen të i ndihmojnë ndërmarrjes në punën e sajë për ti përmirësuar shërbimet. Një problem i veçantë i cili është evident dhe paraqet problem shumë serioz është vazhdimi i mëtutjeshëm i kryerjes së shërbimeve të mbeturinave nga ana e operatorëve ilegal – të pa licencuar. Për këtë dukuri janë në dijeni edhe Inspektorati Komunal dhe zyrtarë të tjerë komunal.

### 4.3. *Plani i shitjes*

Qëllimet kryesore të KRM “ Pastertia ”Sh. A. janë:

- Të ofroj shërbimin më të mirë në grumbullimin e mbeturinave;
- Të rrit shkallën e faturimit dhe inkasimit;
- Të zgjeroj rajonin e shërbimeve- posaçërisht në rajonet rurale;

Këto hapa do të ndërmerrën për përmirësimin e gjendjes momentale:

- Ristrukturimi i vazhdueshëm i organizimit të punëve dhe punëtorëve në ndërmarrje, për të rritur efikasitetin e ndërmarrjes.
- Planet efikase të operimit të stafit bazuar në metodat bashkëkohore të punës si në operativë po ashtu edhe në financa dhe administratë.
- Bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe shoqatat qeveritare dhe joqeveritare.
- Rritja e përpjekjeve të marketingut për ngritjen e vetëdijes mbi ambientin dhe rolin e Kompanisë në këtë aspekt.
- Përgatitja e fletushkave dhe spoteve televizive mbi ambientin në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Mjedisit ,sidomos pas hyrjes ne fuqi të ligjit mbi mbeturinat.

Siç shihet më poshtë, ekziston një potencial i madh për zgjerimin e shërbimeve në regjionin e KRM “Pastertia”SH.A., duke pasur parasysh që momentalisht rreth 80 % e banorëve të amëvisërive është e përfshirë në shërbime . Duke marrë për bazë shtimin natyror të popullësisë prej 0.80 % në vitë, për vitin 2022 regjioni i Pastërtisë do të ketë 184,570 banorë (rreth 31,200 amvisëri). Deri në vitin 2023 ne planifikojmë që ti shërbejmë mbi 30,000 amvisëri, apo mbi 93% të banorëve të regjionit.

**TABELA. PJESËMARRJA NË TREG NË 2023-2025**

Viti	Të dhenat nga ASK REGJISTRIMI 2011	Amvisëritë	Amvisëritë e sherbyera- planifikimi	% e amvisërive	Klientët e regjistruar të bizneseve dhe industr.
	Nr.Banoreve	ekzistuese		Të sherbyera	
2022	184,570	31,200	27,000	87%	3,200
2023	186,046	32,420	30,000	93%	3,800
2024	187,520	33,861	33,861	100%	4,400
2025	189,022	35,452	35,452	100%	5,000

## ***5 Analiza e konkurrentëve në tregun e synuar***

Në mënyrë që të kemi një përcjellje në kohë të duhur për veprim të rezultateve të këtij plani ne do të përdorim disa mekanizma matës për secilin objektiv kryesisht në këto pika:

- ❖ Synimi i realizimit të të hyrave dhe krijimit të shpenzimeve;
- ❖ Synimi i rritjes së ofertave;
- ❖ Synimi i rreth krijimit të tregjeve të reja;
- ❖ Synimi i përfitimit të klientëve të rinj;
- ❖ Synimi i mbajtjes së klientëve ekzistues dhe potencialë;
- ❖ Synimi i kënaqshmërisë së klientëve tanë me shërbimet e ofruara
- ❖ Synimi i pozicionit tonë ndaj konkurrentëve tanë;
- ❖ Synimi i realizimit të projekteve promovuese;
- ❖ Synimi i shfrytëzimit sa ma racional të mjeteve lëvizëse;
- ❖ Synimi i sistemit të komunikimit përmes kontakteve dhe takimeve të përbashkëta me klientët dhe shfrytëzuesit të shërbimeve;
- ❖ Synimi i realizimit të projekteve kapitale sipas kohës dhe buxhetit të paraparë dhe
- ❖ Synimi i inkasimit të mjeteve.

## **6. Organizimi i biznesit**

Organizimi është bërë në tre njësi, ku menaxhmenti dhe një pjesë e madhe administrates është i caktuar në Ferizaj, ndërsa pjesa e operativës dhe stafi i vogël administrativ është në njësit tjerë në Shtime dhe Kaçanik

### ***6.1 Personeli***

KRM “Pastertia” Sh.A është një kompani publike nën administrimin e pushtetit lokal (Komuna e Ferizaj, Shtime dhe Kaçanik janë edhe aksionare të Ndërmarrjes) dhe, në lidhje me menaxhimin e

burimeve njerëzore, bazohet në legjislacionin; Ligjet në fuqi në Kosovë , aktet nënligjore si dhe Rregulloret e brendshme të Kompanisë të hartuara konform ligjeve në fuqi në Kosovë .

Objektivat e kompanisë për burimet njerëzore pranë KRM “Pastertia” Sh.A aktivitetet e saj i realizon në bazë të kërkesave paraprakisht të përcaktuara në kuadër të departamenteve tjera të kompanisë me të vetmin qëllim realizimin e vizionit dhe misionit të kompanisë.

Të gjitha kërkesat e parashtruara nga departamentet e kompanisë në nevoj të shtimit të numrit të punëtorëve ose hapjen e pozitive shtes apo të ndonjë departamenti sipas nevojës duhet të bëhen ndryshime në organogram të cilat duhet të aprovohen nga ana e Bordit të Drejtorëve të KRM “Pastertia” Sh.A., ku të parapara nga ekzekutivi i kompanisë për shtimin e departamentëve kanë qenë departamenti i shitjes dhe i burimeve njerëzore.

Qëllimi i këtij plani biznesi përsa i përket burimeve njerëzore është të stabilizohet dhe modernizohet sistemi (punonjësit, proceset dhe organizimi) duke ndërtuar së pari infrastrukturën dhe duke identifikuar nevojat e fuqisë punëtore për trajnim dhe zhvillim të mëtejshëm.

Burimet Njerëzore janë njerëzit përfshirë (diturinë e tyre, aftësitë dhe shkathtësitë) të cilët kryejnë punët konkrete brenda kompanisë.

Burimet paraqesin mjet nëpërmjet të cilave ndërmarrjet duke kryer misionin e tyre , këto burime i transferojnë në vlera të reja të përdorimit sipas nevojave dhe kërkesave të tregut.

Vizioni i Burimeve Njerëzore është të ketë një sistem funksional dhe modern më të mirin në mesin e ndërmarrjeve të pastrimit në nivel vendi.

Roli i saj është të sigurojë njohuri, këshilla dhe shërbime për të ndihmuar KRM “Pastertia” Sh.A të tërheqë, të zhvillojë dhe të mbajë një fuqi punëtore të talentuar dhe të larmishme.

Numri i të punësuarve në fund të muajit Shtator 2021, ishte 275 punonjës, ndërsa në fund të muajit Shtator 2022, KRM “Pastertia” Sh.A ka të angazhuar gjithsej 278 punonjës, përfshirë Aksionarët, Anëtarët e Bordit, Auditorin e brendshëm, nivelin e lartë drejtues dhe personelin tjetër profesional dhe administrativ.

Numri aktual i të punësuarve më 30 Shtator të vitit 2022 me kontratë të rregullt është dyqind e dyzet e dy (242) punonjës, trembëdhjet (13) punëtor me kontrat pune dhe detyra specifike, nëntë (9) Aksionarë, katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve, një (1) Kryeshef Ekzekutiv, një (1) Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv, dy (2) Zyrtar në Zyrën e Auditimit, dy (2) Zyrtar të Prokurimit, katër (4) në Asistenc Sociale me nga 50.00 euro

KRM PASTERIA Sh.A, e ka këtë mesatare të pagës bazë për vitin 2022, e cila është =**364.40 €**.  
Struktura e këtyre të punësuarve varësisht nga kategoritë e ndara më poshtë është si vijon:

- Mosha mesatare e punëtorëve në KRM PASTERIA Sh.a, është 43.27;
- Punonjës me marrëdhënie të rregullt pune janë 95 %,
- Asistenc sociale janë 1.43%;
- Meshkuj janë 250 punëtor ose 90 %;
- Femra janë 28 punëtore ose 10 %;
- Me shkollim fillor janë 106 punëtorë ose 38.10 %;

- Me shkollim të mesëm janë 128 punëtorë ose 46.05 %;
- Me shkollim të lartë-fakultet janë 40 punëtorë ose 14.40 %;
- Me shkollim superior janë 4 punëtorë ose 1.45 %

Nga të dhënat e verifikuara del se problem shqetësues për KRM PASTERTIA Sh.A, edhe më tutje është mosha e vjetër e punonjësve dhe struktura gjinore e tyre. Mosha e vjetër e punonjësve drejtpërdrejtë ndikon dhe sjell problemin në produktitetin e ulet të punës. etj.Misioni i ndërmarrjes është që të mbulojë me shërbime të gjithë qytetarët e vetë , pa dallim vendbanimin e tyre dhe që të sigurojë shërbime në pajtim me standardet ndërkombëtare

## 7. Plani Financiar.

Pastertia planifikon të arrijë 93% shkallë të faturimit dhe 90% shkallë të inkasimit duke u bazuar në Ligjin për Mbeturina, i cili qartë e përcakton rolin dhe përgjegjësinë e komunave në sektorin e mbeturinave. Pastertia Sh.A. është e gatshme të angazhojë ndonjë institucion për inkasimin e të hyrave. Në këtë rast komuna, do të bënë inkasimin dhe të paguhet për këtë shërbim me 2% të të hyrave të faturuara të KRM “Pastertia” Sh. A.

KRM “Pastertia”Sh. A. ka hartuar planin e të hyrave në bazë të tarifave që ka aprovuar Zyra Rregullatore, në ciklin e më parëshëm tarifor, sipas ligjit 04/L-060 ngirtja e tarifave duhet të bëhet në kuvendet komunale, ku komuna e Ferizajit e ka kaluar rritjen e tarifave për 39% rritje lineare për të gjitha kategoritë dhe tanimë jemi duke pritur vetëm fillimin e fazës së faturimit me tarifa të reja, ndërsa komuna e Kaçanikut dhe Shtimes gjithashtu janë në procesin e rritjes së tarifave dhe presin të kalojnë ato.

**Resurset njerzore dhe pagat** – nuk do të ketë një zvogëlim të rëndësishëm të numrit total të punëtorëve, sepse numri i punëtorëve që janë angazhuar për mirëmbajtjen e rrugëve gjat sezonave mund të mos i fitojmë prap kontratat. Edhe pse pjesën e punëtorëve të veprimtarisë primare, dhe një pjesë të kategorive sekondare (shofer, punëtorë fizik, automekanik, inkasant, punëtorë të sigurimit, automekanik, punëtorë pastrues ) I kemi rritur pagat nga viti 2016 dhe 2021 po ashtu edhe pagesa e shtazhit për punëtorë, mendojmë që KRM “ Pastertia”Sh. A. planifikon rritjen e pagave mujore edhe për një pjesë të kategorive sekondare, menaxhmentit dhe punëtorëve tjerë, kjo rritje do të bëhet edhe në përqindje të ndryshme për secilën kategori. Planifikojmë një rregullim të pagave përmes përcaktimit të koeficientit për çdo pozitë pune.

Në vitin 2023 kompania planifikon që pagat të paguajmë me rregull, duke pretenduar se rritja e tarifave do të krijonte një të hyrë më të madhe e cila do të mbulonte shpenzimet e kompanisë, specifikisht pagat e punëtorëve.

Përveç kësaj, Pastertia planifikon që të stimulojë punëtorët e ekipit grumbullues me;15 % për ekipin e punëtorëve që do ta realizojnë ngarkesën e tretë gjatë një ndërrimi;Dhe normalisht për punën jashtë orarit të rregullt pagesa bëhet sipas ligjit të punës, për të gjithë punëtorët e KRM “ Pastertia” sh.a.

**Detyrimet afat-shkurta** - për periudhën 2023-2025, të mbulohet nga pagesat e borxheve të palëve të involvuara.

**Zbrazëtira Financiare në 2023-2025** – mendohet se do të mbulohen me grante/huazime nga MZHE, MEF, apo nga ndonjë subvencion tjetër qeveritar.

**Pagesat e Rregullta 2023-2025**– Pastertia do të mbulojë rogat, kontributet, taksat (TVSH-në në inkasim, tatimin në pronë dhe taksat komunale ) tatimin në korporata do të paguajmë sipas kësteve tremujore, duke mos garantuar se në përfundim të njëjtë do të vijë edhe në fund të vitit , apo pas hartimit

te pasqyrave financiare, kjo mund të bëhet vetëm nëse Bordi nxjerr vendim për provizionim të borxheve të kqija.

KRM PASTERTIA Sh.A parasheh të zhvillojë afarizmin e vet me një trend të avancimit të lehtë në krahasim me vitet paraprake përkundër vështirësive të ndryshme. Këtë duke e pas parasysh se përveç shpenzimeve operacionale të domosdoshme për funksionim nevojiten edhe burime financiare për projekte kapitale. Aktualisht burimi i vetëm për këto investime është pagesat nga anviserit, bizneset dhe komunat.

KRM PASTERTIA Sh.A në vitin 2022 nuk është përkrahur me subvencione nga ana e qeverise konkretisht nga MZHE, për investime në projektet kapitale siç janë modernizimi i mjeteve lëvizëse apo blerja e mjeteve lëvizëse të përdorura apo të reja, investimet në krijimin e kushteve të punës (zyret), arsya se në vitin 2016 vetëm është ndarë parcela nga komuna e Ferizajt për transferin e operativës jashtë objektit egzistues, për arsye hixhenike pasi e kemi afër ambulance, qerdhen e femijeve, etj. Presim që në vitin 2023 të kemi subvencione nga ana e qeverisë.

Nga analizat e prezantuara më lart është potencuar se biznesi i KRM PASTERTIA Sh.A mbështetet për mbledhjen e mbeturinave (si aktivitetet primar) në komunat e Ferizajt, Shtimes, dhe Kaçanikut , dhe aktivitetet sekondare të KRM “ Pastërtisë “ sh.a. tani për tani janë: Pastrimi i rrugëve dhe heqja e bores.

Nga shënimet që kemi nxjerr nga shërbimi i financave gjendja jonë financiare nuk është shumë e volitshme për të planifikuar investime për zhvillim

### Buxheti i planifikuar për tri vite

Veprimtaria primare + sekondare	2023	2024	2025
Shpenzimet per paga (Pune shtes, kontributi i punedhenesit)	1,450,000.00	1,500,000.00	1,550,000.00
Karburanti (Naft, vaj)	85,000.00	90,000.00	95,000.00
Shpenzimet e mirembajtjes dhe puntoris mekanike	170,000.00	170,000.00	170,000.00
Shpenzimet (ptk,elektrike,gas etj)	14,000.00	15,000.00	16,000.00
Deponimi	280,000.00	290,000.00	300,000.00
Trajnim ant.bordit	7,000.00	7,000.00	7,000.00
Rexhistrimi, Kontrolla teknike, Taksa e Automjeteve	13,000.00	14,000.00	15,000.00
Shpenzimet e autogomave	8,000.00	9,000.00	10,000.00
Shpenzimet e mirembajtjes se programit	12,000.00	13,000.00	13,000.00
Të tjera O&M	90,000.00	100,000.00	110,000.00
<b>Gjithesej shpenzimet operative</b>	<b>2,129,000.00</b>	<b>2,208,000.00</b>	<b>2,286,000.00</b>
Kredi nga Bankat Komerciale (supozuar)	-	-	-
Kredi nga ME ( BERZHI)	-	-	-
OVD nga Bankat komerciale (Mbiterheqje)	-	-	-
Shpenzimet totale me grantin e propozuar	-	-	-
<b>Total:</b>	<b>2,129,000.00</b>	<b>2,208,000.00</b>	<b>2,286,000.00</b>



## Buxheti i planifikuar dhe ndarja në periudha kohore për vitin 2023

Veprimtaria primare + sekondare	2023	Janar-Mars 2023	Janar-Qershor 2023	Janar-Shtator 2023
Shpenzimet per paga (Pune shites, kontributi i punedhensesit)	1,450,000.00	362,500	725,000.00	1,087,500.00
Karburanti (Naft, vaj)	85,000.00	21,250.00	42,500.00	63,750.00
Shpenzimet e mirembajtjes dhe puntoris mekanike	170,000.00	42,500.00	85,000.00	127,500.00
Shpenzimet (ptk,elektrike,gas etj)	14,000.00	3,500,00	7,000.00	10,500.00
Deponimi	280,000.00	70,000.00	140,000.00	210,000.00
Trajnim ant.bordit	7,000.00	1,750.00	3,500.00	5,250.00
Rexhistrimi, Kontrolla teknike, Taksa e Automjeteve	13,000.00	3,250.00	6,500.00	9,750.00
Shpenzimet e autogomave	8,000.00	2,000.00	4,000.00	6,000.00
Shpenzimet e mirembajtjes se programit	12,000.00	3,000.00	6,000.00	9,000.00
Të tjera O&M	90,000.00	22,500.00	45,000.00	67,500.00
<b>Gjithesej shpenzimet operative</b>	<b>2,129,000.00</b>	<b>532,250.00</b>	<b>1,064,500.00</b>	<b>1,596,750.00</b>

Duke pasur parasysh se Njësia Operative Ferizaj, duke pasur parasysh planet tona për ti zgjeruar shërbimet tek shumica e banorëve të regjionit, ne planifikojmë që të rrisim ndjeshëm investimet në periudhën 2023-2025, me këtë radhitje pjesëmarrëse; në kamionë, ndërtesë dhe kontejnerë, Asetet të cilat janë të nevojshme për realizimin e objektivave të lartpërmendura.

Kompanitë për menaxhimin e mbeturinave nevojitet të investojnë rregullisht në pajisje. Ne kemi supozuar se:

- ❖ Çdo 7 vjet do ti zëvendësojmë kamionët;
- ❖ Çdo 5 vjet do ti zëvendësojmë kontejnerët
- ❖ Çdo kamion duhet të ketë 120 kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup>
- ❖ Çdo kamion vetëngarkues duhet të ketë 30 kontejnerë

Automjetet.

Për të zëvendësuar automjetet e vjetruara dhe për të zgjeruar shërbimet, ne duhet të furnizohemi me disa kamionë (shiko tabelën).

### Nevojat dhe kërkesat

#### Makineria

Nr:	Rajoni	Përshkrimi i Automjetit	Sasia	Kapaciteti
1	Ferizaj	Kamion për bartje të mbeturinave	4	16.00 m <sup>3</sup>
2	Shtime	Kamion për bartje të mbeturinave	2	16.00 m <sup>33</sup>
3	Kaqanik	Kamion për bartje të mbeturinave	2	16.00 m <sup>3</sup>
4	Ferizaj	Kamion për bartje të mbeturinave	3	6 deri 10 m <sup>3</sup>
5	Shtime	Kamion për bartje të mbeturinave	1	6 deri 10 m <sup>3</sup>
6	Kaqanik	Kamion për bartje të mbeturinave	1	6 deri 10 m <sup>3</sup>

7	Ferizaj	Autocistern per larjen e rrugëve	2	
8	Ferizaj	Autofshisa per fshirjen e rrugëve	2	
9	Ferizaj	Kamion per pastrimin e reshjeve te debores	2	
10	Ferizaj	Kamioneta per bartjen e mbeturinave	2	
11	Shtime	Kamionet per bartjen e mbeturinave	1	
12	Kaçanik	Kamionet per bartjen e mbeturinave	2	
13	Ferizaj	Ngarkues (SKIP)	1	
Totali			25	

#### Infrastruktura - Zyrat dhe Garazhet.

Aktualisht, KRM “Pastertia” Sh. A. ka tri autoparqe me automjete që shkojnë në të njëjtën deponi. Për arsye se qerdhja e fëmijeve është afër objektit, si dhe për të kursyer në investime dhe zvogëluar shpenzimet operative, KRM “Pastertia” Sh. A. së bashku me kuvendin komunal të Ferizajt, planifikon të ndërtoj një të Objekt të Ri për vendosjen e Njesisë Operative të Ferizajt afër stacionit për transferim në Gërlicë. (Ndërtimi garazheve do të bëhet në Ferizaj për vendosjen e kamionëve të rinj, po ashtu do të ndërtohen objekte për garazhimin e automjeteve, në Shtime dhe në Kaçanik, këto investime totalisht janë të mbështetura në thithjen e granteve qeveritare apo ndihmën e Kuvendeve Komunale).

Investimet për ndërtimtarë janë të parapara për vitin 2022, 2023, 2024 dhe 2025 .

#### Nevojat për objektet e administratës dhe asetet përcjellëse

Nr:	Rajoni	Përshkrimi	Sasia	Kapaciteti
1	Ferizaj	Punëtori me anekse përcjellëse	1	500m <sup>2</sup>
2	Ferizaj	Mbulojë për kamion	1	700m <sup>2</sup>
3	Ferizaj	Objekt për administratë	1	500m <sup>2</sup>
4	Ferizaj	Garazha+Zhveshtore për puntor	1	300m <sup>2</sup> +50m <sup>2</sup>
5	Shtime	Garazha+Zhveshtore për puntor	1	150m <sup>2</sup> +50m <sup>2</sup>
6	Kaçanik	Garazha+Zhveshtore për puntor	1	150m <sup>2</sup> +50m <sup>2</sup>
7	Ferizaj	Ndërtimi I pikave të transferit	1	.....
8	Kaçanik	Ndërtimi I pikave të transferit	1	.....

Aktualisht, KRM “Pastertia” Sh.A ka 600 kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup> , 10 kontejnerë 5-7 m<sup>3</sup>; dhe 6,000 copë kontejnerë plastike duke i zgjeruar shërbimet në zonat rurale do të ketë nevojë për kontejnerë shtesë 1.1 m<sup>3</sup>

#### Nevojat për kontenjer, shporta dhe komposter.

Nr:	Rajoni	Përshkrimi	Sasia	Kapaciteti
1	Ferizaj/regjion	Kontejner	2.500	1.1m <sup>2</sup>
2	Ferizaj/regjion	Kontejner	20	5m <sup>2</sup>

3	Ferizaj/regjion	Komposter/institucione dhe shkolla	100	.....
4	Ferizaj/regjion	Komposter/amvisëri	5	
5	Ferizaj/regjion	Furnizim me shporta	25,000	120L

**Nevoja për asete shtesë për ngritje të efikasitetit të shërbimit**

Nr:	Rajoni	Përshkrimi	Sasia	Kapaciteti
1	Ferizaj/regjion	Mini cisternë e destinuar për pastrimin e kontejnerëve	1	.....
2	Ferizaj/regjion	Paisje për dezinfektim të kontejnerëve	1	.....
3	Ferizaj/regjion	Paisje për pastrim të kamionëve	2	.....
4	Ferizaj/regjion	Kamion i posaqëm për bartjen e mbetjeve shtazore	1	10m <sup>3</sup>
5	Ferizaj/regjion	Kamion për bartje të mbetjeve spitalore	1	10m <sup>3</sup>

**TABELA . INVESTIMET E NEVOJSHME TOTALE NË 2023-2025**

Nr.	Investimet	2023	2024	2025
1	Kamion për bartjen e mbetjeve shtazore	160,000	-	-
2	Kamion 1.1m <sup>3</sup> 3.5 tonë	70,000	70,000	70,000
3	Kamionët vetëgarkues me 2 akse	120,000	-	-
5	Ngarkues (SKIP)	20,000		
4	Kontejnerët 1.1 m <sup>3</sup>	32,000	32,000	32,000
5	Kontejnerët 120 lit.	70,000	42,000	40,000
6	IT harduer	3,500	3,500	3,500
7	Kontinjera për kompestim	2,000	2,500	3,500
8	Cisternë për larje të kontejnerëve	85,000	-	-
	<b>Investimet totale vep.kryesore;€/vit</b>	<b>562,500</b>	<b>150,000</b>	<b>149,000</b>
9	Autofshisa	80,000	40,000	40,000
10	Cisterna për larje të rrugëve	160,000	80,000	-
11	Kamion për pasterimin e bores	168,000	175,000	180,000
12	Miniqendra të transferit – ferizaj	32,000	32,000	32,000
	<b>Investime totale vep. Sekondare</b>	<b>440,000</b>	<b>327,000</b>	<b>252,000</b>
	<b>Gjithesëj investimet e nevojshme</b>	<b>1,002,500</b>	<b>477,000</b>	<b>401,000</b>

Investimet kapitale të paraqitura në tabelën e mësipërme që janë në vlerë prej 1,002,500 € janë shpenzimet e nevojshme të kompanisë. Bazuar në grantet e dhëna të MZHE-së nga vitete paraprake, nuk kemi mundur të realizojmë grante në vlerë më të madhe se 300,000 .00 € por për arsye të mundësisë së konkurimit individual të KRM “Pastertia” sh.a Ferizaj në programe të ndryshme ne kemi vendosur që të përfshihën si programe për investime publike.

Prandaj, plani i tillë i shpenzimeve kapitale vështirë të realizohet, sidomos nga MZHE-ja .Ne edhe më tutje kemi nevojë për këto investime. Ndërkaq në buxhetin e hartuar shuma e shpenzimeve të pa

mbuluara e investimeve kapitale paraqitet si zbrztësirë financiare, e që nënkupton huluntimin e burimeve tjera financiare për plotësimin e kësaj zbrztëre financiare.

Sa i përket investimeve kapitale duhet përmendur mbështetjen e ofruar nga organizata për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ, në kuadër të projektit “Gara për Mjedis të Pastër” në të cilin projekt KRM Pastertia në bashkëpunim me komunat ka fituar grant në vlerë prej 733,995.00 euro. Komuna e Ferizajt ka përfituar nga ky projekt shumë prej 596,614.00 euro dhe Komuna e Kaçanikut shumë prej 137,381.00 euro, derisa komuna e Shtimes ende është në procedurë të përfitimit të këtij granti. Realizimi I këtij projekti është realizuar gjatë vitit 2022, ku kemi pranuar donacion kamionet e rinjë.

### Tarifat e shërbimeve 2022-2025

Me ligjin për TVSH-në nga muaji shtator 2015 tvsh në shërbime është zvogluar nga 16% ne 8%, ku kemi edhe të hyra me tvsh më të vogël, ndërsa shpenzimet siq jane: nafta, mirëmbajtja, shpenzimet e operativës, kanë qenë vazhdimisht në rritje.

Tabela .TARIFAT MUJORE TË PASTERTISE (pa TVSh)

Tarifat Aktuale:

<b>Klientët</b>	<b>Tarifat e aprovuara për 2011 (€/muaj)</b>
<b>Amvisëri</b>	<b>4.31,</b>
<b>Biznese</b>	<b>Kat. I: 6.90</b>
	<b>Kat. II: 9.74</b>
	<b>Kat. III: 16.98;</b>
	<b>11.21/1.1 m3kont. dhe 52.59/5 m3 kont.</b>
<b>Institucione</b>	<b>Kat. I: 4.31</b>
	<b>Kat. II: 11.21</b>
	<b>Kat. III: 43.54;</b>
	<b>11.21/1.1 m3 kont. and 43.54/5m3 kont..</b>

Tarifat e reja me rritje (komuna e Ferizajt):

<b>Kategoria e klientëve</b>	<b>Tarifa e re (pa TVSH) në muaj</b>
Amvisëritë	5.99 €
Bizneset me tarifa kat. 1	9.59 €
Bizneset me tarifa kat. 2	13.54 €
Bizneset me tarifa kat. 3	23.60 €
Bizneset me kontratë 1.1 m3	15.58 €
Bizneset me kontratë 5.0 m3	66.11 €
Institucionet me kontratë 1.1m3	15.58 €
Institucionet me kontratë 5.0m3	66.11 €

Tarifat për grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme dhe të ngurta, si grumbullimi i eshtrave nga mishtoret, grumbullimi i xhamit dhe mbetjeve nga operimet në shëndetësi do të kanë tarifa të veçanta, dhe do të jenë:

Mbetje nga operimet në shëndetësi :

28.00 € për kontenier 1.1 m<sup>3</sup>

140.00 € për kontenier 5.0.m<sup>3</sup>

Mbetjet e eshtrave

117.25 € për ton pa tvsh, apo 126.63 me tvsh

36.21 € për konenier 1.1 m<sup>3</sup>, pa tvsh, ose 39.11 € me tvsh.

Tarifa për shërbim të veçant me konenier 5 m<sup>3</sup> për mbeturina komunale të aprovet në vlerë prej 65.50 € pa tvsh , apo 70.75 € me tvsh.

Tarifa e shërbimit me cisternë të jetë 75.00 € pa tvsh, apo 81.00 € me tvsh.

Tarifa e shërbimit me skip të jetë 86.21 € pa tvsh, apo 93.10 € me tvsh, për orë pune.

Tarifa e shërbimit të heqjes dhe bartjes së mbeturinave nga deponit ilegale me traktor tarifa për një traktor të jet 65.50 € pa tvsh, apo 70.75 me tvsh.

### Të hyrat e planifikuara për vitet (2023 – 2025)

Nr.	Kategoritë e të hyrave	2022	2023	2024	2025
1	6130 Të hyrat nga amvisërit – Ferizaj	1,040,865.00	1,051,273.65	1,061,682.30	1,167,850.53
2	6131 Të hyrat nga amvsërit- Shtime	259,000.00	261,590.00	264,180.00	290,598.00
3	6132 Të hyrat nga amvsërit- Kaçanik	32,000.00	32,320.00	32,640.00	35,904.00
4	6140 Të hyrat nga biznesi- Ferizaj	185,000.00	186,850.00	188,700.00	207,570.00
5	6141 Të hyrat nga biznesi- Shtime	37,000.00	37,370.00	37,740.00	41,514.00
6	6142 Të hyrat nga biznesi- Kaçanik	23,500.00	23,735.00	23,970.00	26,367.00
7	6150 Të hyrat me kontrata- Ferizaj	115,300.00	116,453.00	117,606.00	129,366.60
8	6151 Të hyrat me kontrata- Shtime	12,500.00	12,625.00	12,750.00	14,025.00
9	6152 Të hyrat me kontrata- Kaçanik	14,300.00	14,443.00	14,586.00	16,044.60
10	6170 Të hyat nga institucionet- Ferizaj	65,600.00	66,256.00	66,912.00	73,603.20
11	6171 Të hyrat nga institucionet- Shtime	29,100.00	29,391.00	29,682.00	32,650.20
12	6172 Të hyrat nga institucionet-Kaçanik	31,250.00	31,562.50	31,875.00	35,062.50
13	618F Të hyrat tj. Operative- Ferizaj	5,300.00	5,353.00	5,406.00	5,946.60
14	6193 Të hyrat tj. Financiare	2,300.00	2,323.00	2,346.00	2,580.60
15	6190 Të hyrat nga pastrimi i rrugëve	420,000.00	424,200.00	428,400.00	471,240.00
16	6191 Të hyrat nga pastrimi i rrugëve Shtime	38,889.00	39,277.89	39,666.78	43,633.46
<b>Gjithsejt të hyrat</b>		<b>2,308,029.00</b>	<b>2,311,904.00</b>	<b>2,335,023.04</b>	<b>2,568,525.34</b>

## Ndarja e të Hyrave në periudha kohore;

Nr.	Kategoritë e të hyrave	2023	Janar-Mars 2023	Janar-Qershor 2023	Janar-Shator 2023
1	6130 Të hyrat nga amvsërit - Ferizaj	1,051,273.65	262,818.41	525,636.83	788,455.24
2	6131 Të hyrat nga amvsërit- Shtime	261,590.00	65,397.50	130,795.00	196,192.50
3	6132 Të hyrat nga amvsërit- Kaçanik	32,320.00	8,080.00	16,160.00	24,240.00
4	6140 Të hyrat nga biznesi- Ferizaj	186,850.00	46,712.50	93,425.00	140,137.50
5	6141 Të hyrat nga biznesi- Shtime	37,370.00	9,342.50	18,685.00	28,027.50
6	6142 Të hyrat nga biznesi- Kaçanik	23,735.00	5,933.75	11,867.50	17,801.25
7	6150 Të hyrat me kontrata- Ferizaj	116,453.00	29,113.25	58,226.50	87,339.75
8	6151 Të hyrat me kontrata- Shtime	12,625.00	3,156.25	6,312.50	9,468.75
9	6152 Të hyrat me kontrata- Kaçanik	14,443.00	3,610.75	7,221.50	10,832.25
10	6170 Të hyrat nga institucionet- Ferizaj	66,256.00	16,564.00	33,128.00	49,692.00
11	6171 Të hyrat nga institucionet- Shtime	29,391.00	7,347.75	14,695.50	22,043.25
12	6172 Të hyrat nga institucionet-Kaçanik	31,562.50	7,890.63	15,781.25	23,671.88
13	618F Të hyrat tj. Operative- Ferizaj	5,353.00	1,338.25	2,676.50	4,014.75
14	6193 Të hyrat tj. Financiare	2,323.00	580.75	1,161.50	1,742.25
15	6190 Të hyrat nga pastrimi i rrugëve Ferizaj	424,200.00	106,050.00	212,100.00	318,150.00
16	6191 Të hyrat nga pastrimi i rrugëve Shtime	39,277.89	9,819.47	19,638.95	29,458.42
<b>Gjithsejt të hyrat</b>		<b>2,311,904.00</b>	<b>577,976.00</b>	<b>1,155,952.00</b>	<b>1,733,928.00</b>

## 8.Sfidat

KRM Pastertia tash e një kohë të gjatë ballafaqohet me vështirësi të shumta. Disa prej vështirësive me të cilat po ballafaqohet kompania:

- Pamundësia e zbatimit të ligjit për mbeturina (Ligji për Mbeturina 04/L-060 është aprovuar në vitin 2012 dhe ende nuk implementohet nga komunat, për shkak të kostos financiare);
- Borgjet e shumta të trashëguara;
- Kontestet gjyqësore;
- Mungesa e mekanizmit detyrues të inkasimit;
- Planifikimet jo adekuate buxhetore nga ana e komunave dhe mosharmonizimi real me kërkesat dhe nevojat e kompanisë.
- Makineria e pamjaftueshme dhe tejet e vjetruar;
- Trajtimi i mbetjeve shtazore (mungesa e kompanive të licencuara);
- Numri i madh i rasteve sociale paraqet një sfidë më vete.

Sipas të dhënave në Qendrat për Punë Sociale nga njësitë e kompanisë, numri i rasteve **sociale** është: në **Ferizaj 987** raste, në **Kaçanik 831** raste dhe në **Shtime 420** raste. Gjithsejt numri i rasteve sociale të cilat marrin shërbimet e kompanisë dhe nuk i paguajnë këto shërbime është **2.238 raste**. Një prej sfidave më të rënda për kompaninë është pamundësia e zbatimit të ligjit për mbeturina dhe planifikimet jo adekuate buxhetore nga ana e komunave dhe mos harmonizimi real me kërkesat dhe nevojat e kompanisë.

Të gjitha këto sfida që po e përcjellin kompaninë dhe pamundësia e investimeve kapitale me qëllim të avancimit të shërbimeve dhe zgjerimit të shërbimeve në pjesët e fshatrave ku nuk ofrohet shërbimi bënë që kompania edhe gjatë vitit në vijim të ketë probleme serioze në funksionimin normal të saj. Kjo imponon një angazhim edhe më të madh të stafit menaxhues të kompanisë duke siguruar edhe përkrahjen nga Bordi i Drejtorëve, Komisionet Komunale të Aksionarëve dhe ajo që është me rëndësi vitale për kompaninë, sigurimi i përkrahjes nga ana e komunave aksionare.

